



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 20.10.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 10. Marçela Shehu** (anëtare)
- 11. Erjon Muharremaj** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
7. *Përfaqësues të medias së shkruar dhe audio vizive.*

RENDI I DITËS:

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Naureda Llagami: Përshëndetje të gjithëve!

Duke qenë se të gjithë anëtarët janë të pranishëm, po fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 20 tetor 2020.

Siç jeni në dijeni në këtë rend dite janë 6 çështje për të cilat kërkohet vendimmarrja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, konkretisht:

Së pari kemi zhvillimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Si çështje të dytë kemi shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për emërimin e 19 magjistratëve.

Si çështje të tretë kemi shqyrtimin e projektvendimeve “Për shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 20.10.2020, të diplomuar në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar” dhe “Për shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 20.10.2020, të diplomuar në përfundim të programit dyvjeçar të trajnimit”.

Si çështje të katërt kemi shqyrtimin e projektvendimeve për kualifikimin për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2020-2021: për kandidaten znj. {...}; për kandidatin z. {...}; për kandidatin z. {...}; për kandidatin z. {...}.

Çështja e pestë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Çështja e gjashtë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr.241, nr.242 dhe nr.243, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Jemi dakord me rendin e ditës?

Atëherë, le të fillojmë me çështjen e parë, e cila ka të bëjë me zhvillimin e seancës dëgjimore.

Atëherë, paraprakisht ftojme palët në sallë.

(Hyjnë në sallën e mbledhjes avokati i z. {...}, z. Sokol Gjini, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani dhe Këshilltari pranë Kabinetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z. Periand Teta.)

Duke qenë se palët janë në sallë, deklarojmë hapjen e seancës dëgjimore në ngarkim të magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për shkak të fillimit nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë të procedimit disiplinor ndaj tij, depozituar në Këshill me datë 24.09.2020.

Më lejoni t’ju informoj që kjo seancë dëgjimore është publike, në përputhje me nenin 142 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” dhe për këtë qëllim janë ftuar për të ndjekur gjithashtu në kohë reale përfaqësues të medias së shkruar dhe vizive, prezenca e të cilëve do të mundësohet nëpërmjet platformës “online”, duke respektuar protokollin e COVID-19.

Pa humbur kohë le të kalojmë në verifikimin e prezencës së palëve.

Nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka ardhur vet Inspektori i Lartë i Drejtësisë, zoti Artur Metani.

Artur Metani: Po! – shoqëruar nga Këshilltari pranë Kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z. Perdiand Teta.

Naureda Llagami: Ndërkohë, nga magjistrati, është avokati Sokol Gjini.

Sokol Gjini (Avokati): Prezent!

Me prokurë përfaqësoj zotin {...}, që më ka dhënë tagrat për ta përfaqësuar në këtë seancë.

Naureda Llagami: Edhe një herë?

Sokol Gjini (Avokati): Përfaqësues me prokurë. Më ka dhënë tagrat për ta përfaqësuar në këtë seancë.

Naureda Llagami: Kopje të prokurës, është me nr. Rep. 5749, Kol. 1486, hartuar në Tiranë, 15.10.2020, në zbatim të së cilës i ka dhënë tagrat avokatit Sokol Gjini të përfaqësojë në Këshillin e Lartë Gjyqësor, magjistratin {...}.

Atëherë, pa humbur kohë, më lejoni t'ju informoj që ju bëj me dije se Këshilli me vendimin nr. 374, datë 28.09.2020 ka vendosur hedhjen në short dhe caktimin e relatorit të çështjes, z. Dritan Hallunaj, vendim i cili i është komunikuar palëve në këtë procedim. Lidhur me caktimin e kësaj seance dëgjimore, zoti {...} është njoftuar fillimisht në rrugë elektronike nëpërmjet e-mailit të datës 5 tetor 2020, ora 12:41 nga Sektori i Organizimit të Mbledhjeve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në të njëjtën ditë është protokolluar njoftim shkresë nr. 4812/3 protokollit, datë 05.10.2020 (akt njoftimi) për zhvillimin e seancës dëgjimore në drejtim të magjistratit zotit {...} dhe zotit Metani. Gjithashtu është kontaktuar me telefon nga stafi i Këshillit të Lartë Gjyqësor z. {...} dhe në komunikimin

telefonik është shprehur se ka marrë dijeni për caktimin e seancës dëgjimore nëpërmjet e-mailit dhe ku ka konfirmuar personalisht që do të jetë prezent edhe pranë institucionit.

Nga ana tjetër, rezulton që nga palët në këtë procedurë nuk është paraqitur asnjë kërkesë për përjashtimin e ndonjë anëtari të KLGJ-së nga pjesëmarrja në shqyrtimin e procedurës administrative në fazë paraprake, me argumentin se ekziston një nga shkaqet e parashikuara në nenin 75 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. E njëjta gjë vlen edhe për anëtarët e KLGJ-së të cilët nuk kanë deklaruar deri tani se kanë pengesë ligjore apo konflikt interesi për të marrë në vijim këtë çështje.

Përpara se të vijojmë, dëshiroj t’ju bëj me dije se në zbatim të ligjit dhe të rregullores keni të drejtë për të parashtruar kërkesa procedurale në rast se keni, lidhur me legjitimitetin apo me zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

Sokol Gjini (Avokati): E nderuar Kryetare, kërkesa nuk kemi, vetëm ne do parashtrojmë një parashtrësë në lidhje me vendimmarrjen.

E nderuar Kryetare!

Të nderuar anëtarë të KLGJ-së!

Naureda Llagami: Një sekondë.

Atëherë, nuk keni kërkesa paraprake.

Nga ana e Inspektorit?

Artur Metani: Jo!

Naureda Llagami: Atëherë, duke qenë se nga palët nuk kemi kërkesa paraprake, atëherë kalojmë në deklarimin e hapur të shqyrtimit të procedimit disiplinor. Si fillim, fjala i jepet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili shkurtimisht, duke qenë se raportin e ka depozituar me shkrim, shkurtimisht le t’i përmbahet argumentave dhe objektit të shkeljes dhe më pas i kalohet fjala përfaqësuesit të magjistratit.

Artur Metani: Faleminderit, Kryetare!

Do mundohem të jem shkurt në parashtrësën time. Parashtrësën e gjatë dëshiroj ta depozitoj.

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Me vendimin nr. 664/4 prot., 07 korrik 2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është vendosur fillimi i hetimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja /b/ e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nga neni 104/3 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe të prokurorit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në analizë të dokumentacionit të administruar në kuadër të këtij procesi hetimor, rezultoi e provuar se, gjyqtari {...} me vendimin nr. 129 datë 27.11.2018 të ish-Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe ndryshuar pjesërisht me vendimin nr. 18 datë 27.02.2019 të ish-Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë është deklaruar fajtor për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç të K.Penal.

Vepra penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, për të cilën është gjetur fajtor dhe është dënuar gjyqtari {...}, parashikohet si krim nga neni 319/ç të K.Penal.

Nga ana tjetër rezulton se në rastin konkret janë plotësuar në mënyrë kumulative dy kushtet e parashikuara nga neni 104, pika 3, të Ligjit Nr. 96/2016 dhe konkretisht: (i) gjyqtari të jetë dënuar për kryerjen e një krimi; dhe (ii) vendimi i dënimit të jetë i formës së prerë. Rezulton se vendimi i gjykatës së apelit me nr. 18, datë 27.02.2019 me të cilin është dënuar gjyqtari {...} për kryerjen e krimit të parashikuar nga neni 319/ç i K.Penal, konsiderohet vendim i formës së prerë sipas parashikimeve të nenit 462, pika 3, shkronja “b”, të K.Pr.Penale dhe nenit 428/1 shkronjat “a”, dhe “b” të K.Pr.Penale.

Nga përmbajtja e vendimit gjyqësor të formës së prerë rezulton se gjyqtari {...} është gjetur fajtor për veprime të cilat për nga natyra e tyre janë të shkallës më të rëndë sikundërse janë aktet korruptive të lidhura me ushtrimin e funksionit të gjyqtarit. Rezulton e provuar se shkelja disiplinore e kryer nga gjyqtari {...} është realizuar nëpërmjet veprimeve aktive të marrjes së shumave monetare shumë e cila përbënte një përfitim të parregullt dhe që nuk i takonte ligjërisht në bazë të funksionit që kryente, me qëllim që të ndikohej në kryerjen e detyrës së tij si gjyqtar në gjykimin e çështjes penale. Gjykata me vendim të formës së prerë ka vlerësuar se veprimet e kryera nga gjyqtari {...}

në funksion të veprës penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal janë kryer me dashje direkte e cila është dhe forma më e lartë e fajit në kryerjen e veprës penale.

Referuar fakteve dhe rrethanave të pranuar nga gjykata, rezulton se veprimet e gjyqtarit kanë cenuar veprimtarinë e rregullt të organeve të drejtësisë nga veprimet e parregullta të personave të jashtëm por edhe nga veprimet e vetë atij si funksionar i drejtësisë. Këto veprime kanë cenuar besimin e palëve ndërgjyqëse dhe të publikut në organet e drejtësisë dhe respektimin e ligjit nga ana tyre, si dhe kanë diskretituar rëndë pozitën dhe figurën e magjistratit. Ushtrimi i parregullt i detyrës nga ana e magjistratit ka sjellë pasoja për dhënien e drejtësisë, ka diskretituar rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, si dhe ka cenuar besimin e publikut te drejtësia.

Nga analiza ligjore e fakteve të konstatuara, duke mbajtur në konsideratë: (i) natyrën e shkeljes disiplinore, ajo e kryerjes së një krimi për të cilin është dënuar me vendim të formës së prerë, të parashikuar nga neni 140/2 shkronja b) e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 104 i ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar; faktin që shkelja disiplinore në rastin konkret përbën “Shkelje shumë të rëndë disiplinore”; provohet se magjistrati {...} ka diskretituar pozitën dhe figurën e magjistratit, ka cenuar rëndë imazhin e drejtësisë dhe ka ulur besimin e publikut tek dhënia e drejtësisë.

Duke mbajtur në konsideratë faktin se masa disiplinore është e varur nga ekzistenca e përgjegjësisë disiplinore së magjistratit, në përputhje me parimin e ligjshmërisë, duke u siguruar që masa e dhënë të jetë e parashikuar nga ligji dhe e nevojshme për të përmbushur qëllimin e ligjit; duke u bazuar në kriteret objektive lidhur me rëndësinë e shkeljes disiplinore dhe masës disiplinore; individualizmit dhe proporcionalitetit, pra që ndaj magjistratit të jepet ajo masë që është e domosdoshme dhe e dobishme, për arritjen e qëllimit të procedimit disiplinor ndaj tij, në përputhje me shkeljen disiplinore që ka kryer, vlerësohet për shkeljen disiplinore të kryer nga magjistrati {...} se duhet të jepet masa disiplinore “Shkarkim nga detyra”, parashikuar nga neni 140/2 shkronja b) e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 104/3 dhe 111 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për sa më sipër, kërkojmë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të administrojë provat e paraqitura nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në këtë procedim disiplinor dhe në

mbështetje të nenit 105, pika 1, shkronja “dh”; nenit 111, pika 1; dhe nenit 146, pika 2, shkronja “b” , të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendosë:

“Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 104, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe caktimin ndaj tij të masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Metani!

Atëherë, fjala për përfaqësuesin e magjistratit, për të parashtruar argumentet mbrojtëse.

Sokol Gjini (Avokati): Me datën 05.10.2020 nga administrata e Këshillit të Lartë Gjyqësor është njoftuar se “Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 02.10.2020 ka marrë vendimin nr. 377, “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë”. Sipas këtij vendimi, seanca do të zhvillohet në datën 20.10.2020, në orën 11:00.”

Në lidhje me këtë vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe kërkesës për procedim disiplinor të paraqitur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, kam sqaruar si më poshtë vijon: “Shtetasi {...} nuk është subjekt i hetimit disiplinor, ndërmarrë me vendimin 664/4 prot., datë 07.07.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pasi nuk gëzon statusin e magjistratit referuar ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Më datën 08.04.2019, shtetasi {...} në statusin e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë, me vullnet të lirë e të plotë, para autoritetit përgjegjës Këshillit të Lartë Gjyqësor, ka deklaruar dorëheqjen si gjyqtar, kërkesë e cila është regjistruar me nr. 2067 prot., datë 09.04.2019, i konfirmuar ky me vullnetin e tij për dorëheqje nga detyra e gjyqtarit me shkresën drejtuar autoritetit përgjegjës, Këshillit të

Lartë Gjyqësor, me nr. 3813 prot., datë 15.07.2019, akt i cituar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në faqen 3 të vendimit të tij për fillimin e hetimit disiplinor.

Neni 64 i ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve...”, mbarimi i statusit të magjistratëve, neni 64/1/a parashikon: “1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: a) jep dorëheqjen”. Në neni 65 të ligjit 96/2016, “Dorëheqja”, përcaktohet: 1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.”

Referuar sa më sipër, statusi i shtetasit {...} si magjistrat, ka përfunduar në fund të muajit maj 2019, pasi kërkesa për dorëheqje është referuar edhe nga ana juaj, është dorëzuar para autoritetit përgjegjës me datën 08.04.2019, protokolluar pranë autoritetit përgjegjës Këshilli i Lartë Gjyqësor, me nr. 2067 prot., datë 09.04.2019.

Nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, deri në këtë moment, shtetasit {...} nuk i është komunikuar ndonjë vendimmarrje e KLGJ-së që kërkesa e tij për dorëheqje të jetë refuzuar apo rrëzuar. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në pjesën e dytë për “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, neni 15 dhe neni 18 sanksionon: “1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. 2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.”; në nenin 18: “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive.”

Referuar nenit 97 i Kodit të Procedurës Administrative “Miratimi në heshtje” sanksionohet: “1. Nëse pala ka kërkuar në procedurën administrative nxjerrjen e një akti administrativ shkresor dhe organi publik nuk njofton vendimin brenda afatit të përcaktuar me ligj apo akt nënligjor për përfundimin e procedurës dhe nuk njofton zgjatjen e afatit

ose nuk njofton vendimin brenda afatit të zgjatur, kërkesa konsiderohet si e miratuar dhe akti administrativ shkresor i kërkuar si i miratuar në heshtje... .”

Shtetasi {...} ka kryer detyrën e magjistratit në Gjykatën e Apelit Tiranë e për rrjedhojë, prej momentit të paraqitjes së dorëheqjes nuk konsiderohet më gjykatës i kësaj gjykate, pasi gjykoj se magjistrati nuk mund të qëndrojë në detyrë jashtë vullnetit të tij.

E nderuar Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Në bazë të nenit 64/1/a, nenit 65 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shtetasi {...} nuk gëzon statusin e gjyqtarit dhe për rrjedhojë nuk është subjekt i hetimit disiplinor.

Ndodhur në këto rrethana të sipërcituara, kërkoj pushimin e procedimit disiplinor paraqitur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Ftoj kolegët nëse keni ndonjë pyetje.

Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Jeni njohur me vendimin e fillimit të hetimit disiplinor të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe me raportin e hetimit?

Sokol Gjini (Avokati): Edhe një herë të lutem!

Ilir Toska: Jeni njohur me vendimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...} dhe me raportin e hetimit në lidhje me këtë procedim disiplinor?

Sokol Gjini (Avokati): Po, më datën 07.07.2020! 1 vit pasi shtetasi {...} ka dhënë dorëheqjen.

Ilir Toska: Që keni marrë raportin dhe vendimin? –këtë po ju pyes.

Sokol Gjini (Avokati): Jo!

Më është njoftuar në rrugë elektronike.

Ilir Toska: E dini përmbajtjen e këtyre dy dokumentave apo jo?

Sokol Gjini (Avokati): Në mënyrë figurative, po, pasi ai më ka dhënë tagrat vetëm për të parashtruar... Lidhur me ndjekjen penale që parashtron Inspektori i Lartë i nderuar, çështja është në Gjykatën e Lartë.

Ilir Toska: Më kuptoni se çfarë po ju pyes?

Sokol Gjini (Avokati): Ju kuptoj.

Ilir Toska: Po ju pyes, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë vendim për fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit {...}. Pas kësaj, Inspektorati i Lartë i Drejtësisë ka hartuar edhe raportin e hetimit disiplinor.

Jeni njohur me këto dy dokumenta apo jo?

Sokol Gjini (Avokati): Jo! –vetëm me vendimin e Inspektorit të Lartë.

Ilir Toska: Pyetja e dytë është: Në ç'fazë ndodhet çështja në Gjykatën e Lartë mbi rekursin e bërë nga zoti Miri?

Sokol Gjini (Avokati): Çështja është regjistruar, është ushtruar rekurs nga shtetasi {...}. Është regjistruar dhe pritet për shqyrtim.

Ilir Toska: Nuk ka kaluar as në dhomë këshillimi?

Për çfarë është bërë rekurs?

Sokol Gjini (Avokati): Për pafajësi.

Ilir Toska: Ka kërkuar pafajësi.

Faleminderit!

Sokol Gjini (Avokati): Jemi të bindur në pafajësinë tonë.

Sokol Gjini (Avokati): E nderuar anëtare, ky raport është dhënë jashtë çdo afati. Ai nuk është magjistrat, ka dhënë dorëheqjen. Ka kërkuar dorëheqjen më datën 08.04.2019 dhe s'kemi nevojë të njihemi më atë raport.

Brikena Ukperaj: Ju është komunikuar e drejta për t'u njohur me dosjen e hetimit që ka ardhur nga ana e Inspektorit, jeni konsultuar me materialet e dosjes apo nuk e keni parë të nevojshme, se pretendoni që ai s'e ka pasur statusin e magjistratit?

Sokol Gjini (Avokati): Përveç vendimit, nuk e ka parë të nevojshme të njihet me...

Brikena Ukperaj: Pra ju nuk e mendoni as të paraqisni ndonjë provë tjetër?

Sokol Gjini (Avokati): Jo! Për atë që është paraqitur, ne presim që të shprehet Gjykata e Lartë. Në momentin që ky s'është magjistrat, i ka mbaruar efektet e tij sipas ligjit.

Naureda Llagami: Atëherë, nëse nuk kemi më pyetje, unë i ftoj palët që të dalin jashtë, për të lejuar Këshillin për të vlerësuar.

(Dalim nga salla e mbledhjes avokati i z. {...}, z. Sokol Gjini, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani dhe Këshilltari pranë Kabinetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z. Perand Teta. Vijohet diskutimi vetëm në prezencë të anëtarëve. Pas diskutimeve nga anëtarët, rihyjnë në sallën e mbledhjes palët.)

Naureda Llagami: Atëherë, Këshilli, pasi dëgjoi prapësimet, vendosi që vazhdimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor ndaj zotit {...}, ju në cilësinë e përfaqësuesit keni të drejtë të njiheni me një kopje të akteve në dosje, dhe mund ta thoni se sa kohë ju duhet për t'u njohur?

Sokol Gjini (Avokati): Pesë ditë, të paktën, minimalisht.

Naureda Llagami: Atëherë, shtyrja e seancës dëgjimore me datë 27 tetor, ora 11:00.

Sokol Gjini (Avokati): Ndonjë orar tjetër, ju lutem?

Naureda Llagami: Doni një orar tjetër?

Ora 12:00.

Dakord.

Atëherë, me kaq po e mbyllim seancën dëgjimore për sot.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 20.10.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:

- 2.1 Për emërimin gjyqtar të z. {...} (relator z. Alban Toro);
- 2.2 Për emërimin gjyqtar të z. {...} (relator z. Alban Toro);
- 2.3 Për emërimin gjyqtar të z. {...} (relatore znj. Marçela Shehu);
- 2.4 Për emërimin gjyqtar të z. {...} (relatore znj. Marçela Shehu);
- 2.5 Për emërimin gjyqtar të z. {...} (relatore znj. Marçela Shehu);
- 2.6 Për emërimin gjyqtar të z. {...} (relator z. Ilir Toska);
- 2.7 Për emërimin gjyqtar të z. {...} (relator z. Alban Toro);
- 2.8 Për emërimin gjyqtare të znj. {...} (relator z. Alban Toro);
- 2.9 Për emërimin gjyqtare të znj. {...} (relator z. Ilir Toska);
- 2.10 Për emërimin gjyqtare të znj. {...} (relatore znj. Marçela Shehu);
- 2.11 Për emërimin gjyqtare të znj. {...} (relatore znj. Marçela Shehu);
- 2.12 Për emërimin gjyqtare të znj. {...} (relatorë znj. Marçela Shehu);
- 2.13 Për emërimin gjyqtare të znj. {...} (relator z. Alban Toro);
- 2.14 Për emërimin gjyqtare të znj. {...} (relator z. Alban Toro);
- 2.15 Për emërimin gjyqtare të znj. {...} (relatore znj. Marçela Shehu);
- 2.16 Për emërimin gjyqtare të znj. {...} (relator z. Ilir Toska);
- 2.17 Për emërimin gjyqtare të znj. {...} (relator z. Alban Toro);
- 2.18 Për emërimin gjyqtare të znj. {...} (relatore znj. Marçela Shehu);
- 2.19 Për emërimin gjyqtare të znj. {...} (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

- Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:
 - 2.1 Për emërimin gjyqtar të z. {...} (relator z. Alban Toro);

- 2.2 Për emërimin gjyqtar të z. {...} (relator z. Alban Toro);
- 2.3 Për emërimin gjyqtar të z. {...} (relatore znj. Marçela Shehu);
- 2.4 Për emërimin gjyqtar të z. {...} (relatore znj. Marçela Shehu);
- 2.5 Për emërimin gjyqtar të z. {...} (relatore znj. Marçela Shehu);
- 2.6 Për emërimin gjyqtar të z. {...} (relator z. Ilir Toska);
- 2.7 Për emërimin gjyqtar të z. {...} (relator z. Alban Toro);
- 2.8 Për emërimin gjyqtare të znj. {...} (relator z. Alban Toro);
- 2.9 Për emërimin gjyqtare të znj. {...} (relator z. Ilir Toska);
- 2.10 Për emërimin gjyqtare të znj. {...} (relatore znj. Marçela Shehu);
- 2.11 Për emërimin gjyqtare të znj. {...} (relatore znj. Marçela Shehu);
- 2.12 Për emërimin gjyqtare të znj. {...} (relatorë znj. Marçela Shehu);
- 2.13 Për emërimin gjyqtare të znj. {...} (relator z. Alban Toro);
- 2.14 Për emërimin gjyqtare të znj. {...} (relator z. Alban Toro);
- 2.15 Për emërimin gjyqtare të znj. {...} (relatore znj. Marçela Shehu);
- 2.16 Për emërimin gjyqtare të znj. {...} (relator z. Ilir Toska);
- 2.17 Për emërimin gjyqtare të znj. {...} (relator z. Alban Toro);
- 2.18 Për emërimin gjyqtare të znj. {...} (relatore znj. Marçela Shehu);
- 2.19 Për emërimin gjyqtare të znj. {...} (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Viojmë me çështjen e dytë të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Fillojmë me projektvendimin e parë që i cili ka të bëjë me emërimin e gjyqtarit z. {...}. Relator është zoti Alban Toro.

Alban Toro: Më herët Këshilli ka vendosur me vendimin nr. 367, datë 28.09.2020, “Për kualifikimin për emërim të kandidatit të diplomuar në shkollën e magistraturës, z. {...}”, në kushtet kur ai plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit sipas nenit 136/a të Kushtetutës dhe të nenit 35 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni ju ka propozuar emërimin e tij si

gjqtar. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet kandidatit. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në miratimin e projekt-aktit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtar z. {...}. 2.Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidatit. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës, që ka të bëjë me emërimin gjyqtar të z. {...}Sërish relator është Alban Toro.

Alban Toro: Për zotën {...} Këshilli ka disponuar me vendimin nr. 366, datë 28.09.2020 ku është vendosur kualifikimi i tij dhe vijimi i procedurës së emërimit. Në kushtet kur ai plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit sipas nenit 136/a të Kushtetutës dhe të nenit 35 dhe 165 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky Komision ju ka sugjeruar projektin e vendimit ku konkludohet emërimi i tij si gjyqtar. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidatit. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtar z. {...}. 2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidatit. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me emërimin gjyqtar të z. {...}.
Relatore është zonja Marçela Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit, Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi përfundoi procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtar të kandidatit z. {...}, me vendimin nr. 360, datë 28.09.2020, ka vendosur kualifikimin e tij dhe vijimin e procedurës së emërimit, pasi nuk janë evidentuar të dhëna që mund të sjellin skualifikimin e tij.

Në vijim të kësaj procedure, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar projektvendimin “Për emërimin gjyqtar të z. {...}”, sipas të cilit ky kandidat, i diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2019-2020, emërohet gjyqtar në kushtet kur ai plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit sipas nenit 136/a të Kushtetutës së

Republikës së Shqipërisë dhe nenit 35 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kalojmë në diskutim, nëse jo, në votim.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtar z. {...}. 2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet gjyqtarit të emëruar. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë tek projektvendimi “Për emërimin gjyqtar të z. {...}”. Edhe për këtë relatore është znj. Marçela Shehu.

Marçela Shehu: Edhe për kandidatin z. {...} është realizuar procedura e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore. Me vendimin nr. 356, datë 28.09.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur kualifikimi i tij dhe vijimi i procedurës së mëtejshme të emërimit.

Në vijim të kësaj procedure, pasi ka konkluduar se ky kandidat i plotëson kushtet dhe kriteret që përcakton Kushtetuta dhe ligji për emërimin si gjyqtar, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka paraqitur Këshillit një projektvendim duke propozuar emërimin e këtij kandidati si gjyqtar.

Naureda Llagami: Faleminderit, znj Shehu!

Kalojmë në votim nëse s'kemi diskutime?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtar z. {...}. 2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet gjyqtarit të emëruar. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës, që ka të bëjë me emërimin gjyqtar të z. {...}. Edhe për këtë relatore është zonja Shehu.

Marçela Shehu: Edhe për kandidatin z. {...}, pas verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore, Këshilli ka disponuar me vendimin nr. 361, datë 28.09.2020, duke vendosur kualifikimin e tij dhe vijimin e procedurës së emërimit.

Në vijim të kësaj procedure, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, pasi ka konkluduar se ky kandidat i plotëson kushtet dhe kriteret që përcakton Kushtetuta dhe ligji për t'u emëruar gjyqtar, çmon t'i propozojë Këshillit të Lartë Gjyqësor emërimin si gjyqtar të këtij kandidati.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Shehu!

Nëse nuk kemi ndonjë diskutim mbi përmbajtjen e projekt-aktit, kalojmë në votimin e tij?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtar z. {...}. 2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet gjyqtarit të emëruar. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me emërimin si gjyqtar, zotin {...}. Relator është zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, zoti {...} është i sapodiplomuar në Shkollën e Magjistraturës. Më herët Këshilli i Lartë Gjyqësor ka verifikuar plotësimin nga kandidati të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për t'u emëruar gjyqtar. Me vendimin nr. 406, datë 09.10.2020 ka vendosur kualifikimin e tij për emërim, për rrjedhojë, në zbatim të ligjit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që Këshilli të vendosë të emërojë gjyqtar z. {...}. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Kalojmë në votim, nëse nuk kemi diskutim mbi projekt-aktin?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtar z. {...}. 2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet gjyqtarit të emëruar. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë tek kandidati i radhës, që ka të bëjë me z. {...}. Relator është Alban Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Në përfundim të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatëve për gjyqtarë, ky Këshill me vendimin nr. 368, datë 28.09.2020, ka vendosur kualifikimin e zotit Baçi dhe vijimin e procedurës së emërimit. Në kushtet kur ky i fundit plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit sipas nenit 136/a të Kushtetutës si dhe nenit 35 të ligjit 96/2016 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë', Komisioni ju propozon emërimin e tij si gjyqtar. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidatit. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim mbi projekt-aktin, kalojmë në votimin e tij?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtar z. {...}. 2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidatit. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me emërimin gjyqtare të znj. {...}. Edhe për këtë relator është zoti Toro.

Alban Toro: Pasi ky Këshill ka konkluduar se kandidatja {...} nuk ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin nga kandidimi si gjyqtare, me vendimin nr. 362, datë 28.09.2020 ka vendosur kualifikimin dhe vijimin e procedurës së emërimit. Në kushtet kur kjo e fundit plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit sipas nenit 136/a të Kushtetutës dhe nenit 35 të ligjit 96/2016, Komisioni ju propozon emërimin e saj si gjyqtare. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidates dhe ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, kalojmë në diskutim. Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtare znj. {...}. 2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidates. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës, që ka të bëjë me emërimin gjyqtare të znj. {...}. Relator z. Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Zonja {...} ka përfunduar dhe është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës për magjistrat, në përfundim të këtij viti akademik. Është bërë verifikimi i përmbushjes nga ana e saj të kushteve dhe kriterëve të emërimit si gjyqtare. Me vendimin nr. 354, datë 28.09.2020, Këshilli ka vendosur të kualifikojë atë për emërim. Mbi këtë bazë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin me të cilin i propozon Këshillit që të emërojë gjyqtare znj. {...}. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtare znj. {...}. 2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet gjyqtares së emëruar. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me emërimin gjyqtare të znj. {...}. Për këtë, relatores është zonja Shehu.

Marçela Shehu: Edhe për kandidaten {...} Këshilli ka realizuar procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtare të saj dhe me vendimin nr. 357, datë 28.09.2020 është disponuar duke vendosur kualifikimi i saj dhe vijimi i procedurës së emërimit. Në vijim të kësaj procedure Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar projektvendimin “Për emërimin gjyqtare të znj. {...}”, duke i propozuar Këshillit emërimin e saj si gjyqtare, në kushtet kur rezulton që ajo plotëson kushtet dhe kriteret që përcakton ligji dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim mbi projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtare znj. {...}. 2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet gjyqtares së emëruar. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me emërimin gjyqtare të znj. {...}. Dhe për këtë relatore është znj. Marçela Shehu.

Marçela Shehu: Edhe për kandidaten znj. {...}, e diplomuar në vitin akademik 2019-2020, pas realizimit të procedurës së verifikimit me vendimin nr. 358, datë 28.09.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur kualifikimi i saj dhe vijimi i procedurës së emërimit. Në vijim të kësaj procedure, pasi është konkluduar se kjo kandidate plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit si gjyqtare, sipas nenit 136 të Kushtetutës dhe ligjit "Për statusin", Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar projektvendimin përkatës, duke i propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor emërimin si gjyqtare të kësaj kandidateje.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim mbi projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtare znj. {...}. 2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet gjyqtares së emëruar. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me emërimin si gjyqtare të znj. {...}. Edhe për këtë, relatore është zonja Shehu.

Marçela Shehu: Për kandidaten {...}, me vendimin nr. 378, datë 02.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur kualifikimi i saj dhe vijimi i procedurës së emërimit. Në vijim të kësaj procedure, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, pasi ka konkluduar se kjo candidate plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në Kushtetutë dhe në ligj për t'u emëruar si gjyqtare, ka përgatitur projektvendimin përkatës, duke i propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor emërimin si gjyqtare të znj. {...}.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim mbi projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtare znj. {...}. 2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet gjyqtares së emëruar. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me emërimin gjyqtare të znj. {...}. Për më shumë detaje, fjalën ia jap relatorit Alban Toro.

Alban Toro: Ky Këshill, pasi ka konkluduar se për kandidaten {...} nuk ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin e kandidimit për emërim si gjyqtare, me vendimin nr. 363, datë 28.09.2020, ka konkluduar kualifikimin dhe vijimin e procedurës së emërimit. Në kushtet kur kjo e fundit plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit sipas nenit 136/a të Kushtetutës dhe nenit 35 të ligjit 96/2016, ky Komision ju ka propozuar emërimin e saj si gjyqtare. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet kandidates. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Kemi ndonjë diskutim për projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtare znj. {...}. 2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidates. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me emërimin si gjyqtare të znj. {...}. Edhe për këtë projekt-akt, relator është zoti Alban Toro.

Alban Toro: Më herët ku Këshill me vendimin nr. 364, datë 28.09.2020 ka vendosur kualifikimin e zonjës {...} dhe vijimin e procedurës së emërimit. Në kushtet kur ajo plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit sipas nenit 136/a të Kushtetutës dhe nenit 35 dhe 165 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë”, ky Komision ju ka propozuar emërimin e saj si gjyqtare. Një kopje e këtij vendim i njoftohet kandidates. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nëse s'kemi diskutim, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtare znj. {...}. 2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidates së emëruar. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me emërimin si gjyqtare të zonjës {...}. Për më shumë detaje fjalën e ka zonja Shehu.

Marçela Shehu: Zonja {...} është e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2019-2020. Me vendimin nr. 359, datë 28.09.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së emërimit, pasi ka vlerësuar se nuk rezultojnë lidhur me këtë kandidate rrethana që mund të vinin në diskutim kualifikimin e saj.

Në vijim të kësaj procedure, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar projektvendimin “Për emërimin gjyqtare të znj. {...}” në kushtet kur ka rezultuar që ajo plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit sipas Kushtetutës dhe ligjit.

Në këto kushte, Komisioni i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor emërimin gjyqtare të znj. {...}.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votim.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtare znj. {...}. 2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet gjyqtarës së emëruar. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me emërimin si gjyqtare të zonjës {...}. Relator është zoti Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Zonja {...} ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës për magjistrat, e diplomuar në këtë vit akademik. Këshilli më herët ka verifikuar plotësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për emërimin e saj si gjyqtare referuar vendimit të tij nr. 355, datë 28.09.2020. Mbi këtë bazë Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit që të vendosë të emëroj gjyqtare znj. {...}. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtare znj. {...}. 2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet gjyqtares së emëruar. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me emërimin si gjyqtare të znj. {...}. Relator është z. Toro.

Alban Toro: Me vendimin nr. 369, datë 28.09.2020, për kandidaten znj. {...} është vendosur kualifikimi dhe vijimi i procedurës së emërimit në kushtet kur ajo plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit sipas nenit 136/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 35 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni ju ka propozuar emërimin e saj si gjyqtare. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet kandidates. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në procedurën e votimit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtare znj. {...}. 2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet kandidates së emëruar. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë tek projekt-akti i radhës, që ka të bëjë me emërimin si gjyqtare të znj. {...}. Për këtë relatore është zonja Shehu.

Marçela Shehu: Zonja {...} është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2019-2020. Me vendimin nr. 370, datë 28.09.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur kualifikimin e kësaj kandidateje dhe vijimin e procedurës së emërimit. Në vijim të kësaj procedure, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, pasi ka vlerësuar se kjo kandidate plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligj dhe Kushtetutë për t'u emëruar gjyqtare, ka vlerësuar të paraqesë Këshillit të Lartë Gjyqësor një projektvendim “Për emërimin gjyqtare të znj. {...}”.

Naureda Llagami: Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtare znj. {...}. 2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet gjyqtarës së emëruar. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projekt-aktin e fundit, që ka të bëjë me emërimin si gjyqtare të zonjës {...}. Relator i këtij projekt-akti është zoti Alban Toro.

Alban Toro: Me vendimin nr. 365, datë 28.09.2020 ky Këshill ka vendosur kualifikimin e zonjës {...} dhe vijimin e procedurës së emërimit. Në kushtet kur kjo e fundit plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit sipas nenit 136/a të Kushtetutës dhe nenit

35 të ligjit 96/2016, Komisioni ju ka propozuar emërimin e saj si gjyqtare. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet kandidatës. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në procesin e votimit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të emërojë gjyqtare znj. {...}. 2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidatës së emëruar. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 20.10.2020)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:

3.1 “Për shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 20.10.2020, të diplomuar në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar”;

3.2 “Për shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 20.10.2020, të diplomuar në përfundim të programit dyvjeçar të trajnimit”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:

3.1 “Për shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 20.10.2020, të diplomuar në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar”;

3.2 “Për shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 20.10.2020, të diplomuar në përfundim të programit dyvjeçar të trajnimit”.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 20.10.2020, të diplomuar në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar dhe për shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 20.10.2020, të diplomuar në përfundim të programit dyvjeçar të trajnimit. Për më shumë detaje fjalën e ka zoti Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur dy projektvendime, siç u relatua edhe nga Kryetarja. Lidhur me këtë, në të dy projektvendimet është përgatitur një relacion, ku shpjegohet edhe shkaku i përgatitjes së tyre.

Shkurtimisht mund t'ju bëj të ditur se Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi përfundoi procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtarë të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2019-2020, në mbledhjen e ditës së sotme bëri emërimin e tyre si gjyqtarë, mbështetur në nenin 35 dhe 165, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ndërkohë, në ushtrim të përgjegjësisë dhe të funksionit të përcaktuara në nenet 147, pika 1 dhe 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në përmbushje të detyrimit të përcaktuar në nenin 39, pika 1, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të shpallë pozicionet e lira për gjyqtarët e emëruar më datë 20.10.2020, ku për këtë qëllim janë përgatitur dhe dy projektvendimet përkatëse, në kushtet kur, sikurse jeni në dijeni, për vitin akademik 2019-2020, si rast përjashtimor, për shkak të ligjit, janë diplomuar dy kategori kandidatësh për magjistratë, profili gjyqtarë, referuar mënyrës së rekrutimit dhe programit të studimit të ndjekur.

Konkretisht, me shkresën nr. 459 prot., datë 09.07.2020, sikurse kërkon neni 34, i Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Shkolla e Magjistraturës ka përcjellë listën e kandidatëve të diplomuar për magjistratë, profili gjyqtar, në përfundim të vitit akademik 2019-2020. Në fakt, përmes kësaj shkrese, janë dërguar dy lista të të diplomuarve për magjistratë, kandidatë për gjyqtarë. Njëra listë është ajo për “Klasifikimin e kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që kanë mbaruar vitin e dytë në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2019-2020”, cilësuar si “kandidatë për magjistratë, subjektet ex officio”, miratuar me Vendimin nr.16, datë 29.06.2020, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, ndërsa lista tjetër është ajo për “Klasifikimin e kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që kanë mbaruar vitin e tretë në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2019-2020”, miratuar me Vendimin nr.17, datë 29.06.2020, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

Kështu, referuar edhe materialeve të dërguara nga Shkolla e Magjistraturës, në përfundim të këtij viti akademik, rezulton të jenë diplomuar 13 (trembëdhjetë) magjistratë, profili gjyqtar, të cilët: a) janë rekrutuar si kandidatë për gjyqtarë, sipas mënyrës bazë të përcaktuar nga ligji dhe konkretisht Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe Ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, pra nëpërmjet provimit të pranimit në formimin fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës; b) kanë ndjekur formimin fillestar për magjistratë në Shkollën e Magjistraturës, për një periudhë trevjeçare, që përfshin: i)një vit program teorik; ii)një vit program praktik paraprofesionale; iii)një vit praktikë profesionale.

Po ashtu, në përfundim të këtij viti akademik, rezulton të jenë diplomuar edhe 6 (gjashtë) magjistratë, profili gjyqtar, të cilët: a) janë rekrutuar si kandidatë për gjyqtarë, sipas mënyrës përjashtimore të përcaktuar në nenin 165 të Ligjit për Statusin, pra nëpërmjet testimit të aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, për këshilltarët e gjyqtarëve pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësve ligjorë në gjykatat administrative, si dhe inspektorëve në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, të cilët nuk gëzonin statusin e gjyqtarit, por që ishin subjekte rivlerësimi “ex officio” sipas pikës 4, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; b) kanë ndjekur programin e trajnimit për magjistratë në Shkollën e Magjistraturës, për një periudhë dyvjeçare, që përfshin: i)një vit program teorik; ii)një vit praktikë profesionale.

Referuar përcaktimeve të neneve 34, 35, 39 dhe 165, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në kushtet kur renditja nga Shkolla e Magjistraturës e të sapodiplomuarve në dy lista krijonte një situatë problematike sa i përkiste caktimit të tyre në pozicion pas emërimit, për shkak se ligji përcakton: a) shpalljen e vendeve të lira për të emëruarit, pa bërë dallim mes kategorive që ata iu përkasin dhe b) përmbushjen e preferencave të të emëruarve, në përputhje me renditjen e tyre në listën e të diplomuarve, duke nënkuptuar kështu ekzistencën e një liste të vetme të tyre, Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi diskutoi këtë problematikë në mbledhjen e datës 23.07.2020, vendosi t’i kërkojë Shkollës së Magjistraturës, si organi kompetent që

bën renditjen e kandidatëve për magistratë, të unifikonte listën e të diplomuarve për magistratë, profili gjyqtar, për vitin akademik 2019-2020.

Në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Shkolla e Magistraturës, me shkresën nr.543/1 prot., datë 18.09.2020, ka njoftuar se: “nuk mund të bëjë një klasifikim dhe renditje për 19 kandidatë për magistratë profile gjyqtar (13 kandidatë që kanë përfunduar Programin e Formimit Fillestar dhe 6 kandidatë për magistratë subjekte rivlerësimi “ex officio” që kanë përfunduar Programin Dyvjeçar të Trajnimit)”, duke parashtruar edhe shkaqet se përse nuk mund të bënte këtë klasifikim dhe renditjeje për 19 kandidatët për magistratë.

Ndodhur në këto kushte, ndërsa ka përgjegjësinë dhe detyrimin ligjor për caktimin në pozicion të të diplomuarve, të emëruar tashmë si gjyqtarë, në përmbushje të preferencave të të emëruarve, në përputhje me renditjen e tyre në listën e të diplomuarve, Këshilli do të duhet të shpallë vendet e lira për secilën kategori të emëruarish, pra për ata që janë diplomuar në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar dhe për ata që janë diplomuar në përfundim të programit dyvjeçar të trajnimit.

Për këtë shkak, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur dy projektvendime, njëri i titulluar “Për shpalljen e pozicioneve të lira për të emëruarit më datë 20.10.2020, të diplomuar në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar” dhe tjetri i titulluar “Për shpalljen e pozicioneve të lira për të emëruarit më datë 20.10.2020, të diplomuar në përfundim të programit dyvjeçar të trajnimit”.

Në pikat 1 respektive të të dy projektvendimeve, përcaktohet pikërisht shpallja e pozicioneve të lira sipas së secilës kategori të diplomuarish, në vitin akademik 2019-2020 dhe të emëruar gjyqtarë më datë 20.10.2020. Në këtë rast është mbajtur në konsideratë përcaktimi i bërë në nenin 25, pika 1, të Ligjit nr.48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit “Deri në miratimin nga këshillat të akteve nënligjore të vlerësimit etik dhe profesional të magistratëve dhe të realizimit të procedurave të vlerësimit, sipas këtij ligji, por jo më vonë se afati i caktuar për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të magistratëve, emërimi i kandidatëve të diplomuar në Shkollën e Magistraturës, që sipas ligjit është parësor, nuk do të ndërvohet nga përfundimi i procedurave të transferimit paralel dhe/ose të ngritjes në detyrë për magistratët”. Pra,

pavarësisht se sipas nenit 39, pika 1, të ligjit në fjalë, pozicionet e lira për të emëruarit duhet të shpallen “pas përfundimit të procedurave të transferimit paralel dhe ngritjes në detyrë”, ndërsa aktualisht jemi nën regjimin e dispozitës kalimtare, Këshilli do të duhet të shpallë pozicionet e lira për të emëruarit më datë 20.10.2020, pa kryer më parë lëvizjet paralele dhe të ngritjes në detyrë.

Në pikën 2 të projektvendimeve respektive përcaktohen pozicionet e lira në gjykatat përkatëse, për secilën kategori të emëruarish. Kështu, për të emëruarit e diplomuar në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar, në total parashikohet shpallja e 13 pozicioneve të lira, pra sipas numrit të të emëruarve të kësaj kategorie. Ndërsa për të emëruarit e diplomuar në përfundim të programit dyvjeçar të trajnimit, në total parashikohet shpallja e 6 pozicioneve të lira, pra sipas numrit të të emëruarve të kësaj kategorie.

Lidhur me përcaktimin e një numri të tillë pozicionesh të lira është mbajtur në konsideratë përcaktimi i bërë në nenin 25, pika 2, të Ligjit nr.48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit “Për shpalljen e pozicioneve të lira për kandidatët për magjistrat të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në çdo rast, Këshillat vlerësojnë mbarëvajtjen e sistemit të drejtësisë dhe, në veçanti, nevojat urgjente të gjykatave dhe prokurorive në këndvështrim të funksionalitetit të tyre”.

Pikërisht, referuar kësaj dispozite, por edhe në konsideratë të përcaktimeve të nenit 15, pika 4, shkronja “a” dhe të nenit 90, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, sipas pikave 2 të projektvendimeve të propozuara janë përcaktuar në total 19 pozicione të lira, që i korrespondon numrit të gjyqtarëve të emëruar më datë 20.10.2020, por që mban në konsideratë edhe pozicionet e lira në tërësi në sistemin gjyqësor në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe atë administrativ, në kuptimin e plotësimit pikërisht të atyre pozicioneve që paraqesin nevoja urgjente në pikëpamje të funksionalitetit aktual të tyre, por edhe në një të ardhme të afërt referuar projeksioneve për mbarëvajtjen e sistemit të drejtësisë.

Sa i përket pozicioneve të lira të shpallura për secilën kategori të emëruarish është mbajtur në konsideratë një shpërndarje e drejtë mes tyre, referuar numrit të pozicioneve

të lira në secilën nga gjykatat që paraqesin nevoja urgjente në pikëpamje të funksionalitetit aktual të tyre.

Po ashtu është mbajtur në konsideratë edhe madhësia e gjykatave, por edhe distanca fizike e tyre me kryeqytetin. Mbi këto faktorë, pikat 2 të projektvendimeve, janë propozuar në dy variante, por që për lehtësi janë paraqitur si projektvendime më vete, identifikuar Varianti I dhe Varianti II. Variantet janë në varësi dhe harmoni me njeri tjetrin, që do të thotë se variantit I të projektvendimit për kategorinë e të diplomuarve në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar, nga ana tjetër i korrespondon Varianti I i projektvendimit për kategorinë e të diplomuarve në përfundim të programit dyvjeçar.

Ndërkohë, në pikat 3 të secilit projektvendim, parashikohet e drejta e të emëruarve, referuar pikës 3 të nenit 35, si dhe pikave 3 dhe 4 të nenit 36, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për të përcaktuar, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata nga ato sipas pikës 2 të projektvendimeve, në të cilat ata kërkojnë të caktohen.

Në pikën 4 të secilit projektvendim, parashikohet detyrimi i të emëruarve, referuar nenit 8 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për deklarimin e situatës së papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3 të kësaj dispozite ligjore.

Më tej, në pikën 5 të projektvendimeve parashikohet afati i aplikimit nga të emëruarit, afat ky që është përcaktuar deri më datë 23.10.2020, pra 3 ditë, afat ky që vlerësohet i mjaftueshëm për të paraqitur ata preferencat e tyre. Në këtë pikë të projektvendimit është përcaktuar edhe se mungesa e aplikimit, pra mungesa e paraqitjes së preferencave nga të emëruarit, nuk passjell ndalimin e procedurës së caktimit të tyre në pozicion. Për këtë përcaktim, sikundër edhe sa i përket afatit të aplikimit, është mbajtur parasysh se të emëruarit në rastin konkret, për shkak të mosemërimit dhe caktimit në pozicion brenda muajit korrik të vitit kur ata janë diplomuar, sipas nenit 39, pikat 1 dhe 2, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë iniciuar një proces gjyqësor përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në të cilin kanë kërkuar detyrimin e Këshillit për t'i dëmshpërblyer për periudhën deri në emërimin dhe caktimin e tyre në pozicion. Pra, të

emëruarit në rastin konkret, përmes inicimit të këtij procesi gjyqësor, “de facto” kanë kërkuar emërimin dhe caktimin e tyre në pozicion në vitin kur janë diplomuar, domethënë jo në vitin pasues, sikurse ua jep këtë të drejtë pika 2 e nenit 35 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në pikën 6 të projektvendimeve përcaktohen dokumentet që të emëruarit duhet të dorëzojnë në momentin e aplikimit, konkretisht: a) Një deklaratë me shkrim ku përcakton, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata nga ato sipas pikës 2 të këtij vendimi, në të cilat kërkon të caktohet; b) Një vetëdeklarim me shkrim, sipas Shtojcës së këtij vendimi, ku të deklarojë nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Së fundi, në projektvendime parashikohet hyrja në fuqi, pikërisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky është relatimi sa i përket dy projektvendimeve.

Mund t’ju them, që në fillim, sa i parket Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është për variantin e parë të propozuar. Gjithsesi, Këshilli le të diskutojë dhe të vendosë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Ka ndonjë diskutim?

Marçela Shehu: Janë dy variante.

Komisioni vet është dakord me variantin e parë.

Naureda Llagami: Atëherë, hedhim në votim propozimin e Komisionit, pra që është varianti i parë. Më pas kalojmë me variantin e dytë.

Kalojmë në votim.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Kundër dhe duhet të them sepse jam për variantin e dytë.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Kundër.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Medi Bici: Kundër.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli me shumicë votash miratoi variantin e parë, pra variantin e ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:

1. Shpalljen e pozicioneve të lira për të diplomuarit në përfundim të programit dyvjeçar të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020 dhe të emëruar gjyqtarë më datë 20.10.2020.

2. Pozicionet e lira janë si më poshtë: a) një pozicion në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë; b) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier; c) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë; ç) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë; e) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër; ë) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

3. Të emëruarit sipas pikës 1 të këtij vendimi kanë të drejtë të përcaktojnë, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata nga ato sipas pikës 2 të këtij vendimi, në të cilat ata kërkojnë të caktohen.

4. Të emëruarit sipas pikës 1 të këtij vendimi kanë detyrimin të deklarojnë situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 3, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

5. Afati i aplikimit është deri më datë 23.10.2020. Mungesa e aplikimit nuk passjell ndalimin e procedurës së caktimit në pozicion të të emëruarve.

6. Në momentin e aplikimit të emëruarit sipas pikës 1 të këtij vendimi, duhet të dorëzojnë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor këto dokumente: a) Një deklaratë me shkrim ku përcakton, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata nga ato sipas pikës 2 të këtij vendimi, në të cilat kërkon të caktohet; b) Një vetëdeklarim me shkrim, sipas Shtojcës së këtij vendimi, ku të deklarojë nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë

ambientale sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu, Këshilli vendosi:

1. Shpalljen e pozicioneve të lira për të diplomuarit në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020 dhe të emëruar gjyqtarë më datë 20.10.2020.

2. Pozicionet e lira janë si më poshtë: a) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat; b) dy pozicione në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier; c) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë; ç) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë; d) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin; dh) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë; e) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat; ë) dy pozicione në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet; f) dy pozicione në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë; g) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

3. Të emëruarit sipas pikës 1 të këtij vendimi kanë të drejtë të përcaktojnë, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata nga ato sipas pikës 2 të këtij vendimi, në të cilat ata kërkojnë të caktohen.

4. Të emëruarit sipas pikës 1 të këtij vendimi kanë detyrimin të deklarojnë situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 3, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

5. Afati i aplikimit është deri më datë 23.10.2020. Mungesa e aplikimit nuk passjell ndalimin e procedurës së caktimit në pozicion të të emëruarve.

6. Në momentin e aplikimit të emëruarit sipas pikës 1 të këtij vendimi, duhet të dorëzojnë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor këto dokumente: a) Një deklaratë me shkrim ku përcakton, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata nga ato sipas pikës 2 të këtij vendimi, në të cilat kërkon të caktohet; b) Një vetëdeklarim me shkrim, sipas Shtojcës së këtij vendimi, ku të deklarojë nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në çështjet e tjera të rendit të ditës, që janë me dyer të mbyllura.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor